

RELACION
PËR
PROJEKTLIGJIN
“PËR ZYRËN E RIKUPERIMIT TË ASETEVE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij Projektligji është ngritja e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve (ZRA), në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si autoritet kombëtar dhe strukturë e posaçme qendrore, e cila është përgjegjëse për procesin e gjurmimit dhe identifikimit të të ardhurave, pasurive ose përfitimeve të tjera pasurore që lindin nga një veprë penale ose veprimtari kriminale, të cilat mund të nënshtrohen ngrirjes së përkohshme, sekuestrimit ose konfiskimit nga organet kompetente. ZRA gëzon pavarësi operacionale dhe gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe përgjegjësisë bazohet në parimet e profesionalizmit dhe integritetit, respektimi të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, urgjenca dhe efikasiteti, besimi reciprok, konfidencialiteti, pavarësia operacionale, paanshmëria politike, komunikimi i drejtpërdrejtë dhe elektronik, ruajtja e informacionit të klasifikuar.

Objektivi i këtij Projektligji është krijimi dhe funksionimi i ZRA në përputhje me kërkesat e Bashkimit Evropian, në përmbushje të objektivave dhe prioritetëve të Qeverisë së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme, specifikuar në Planin Kombëtar të Integritimit European 2024-2026 dhe Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2024.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Hartimi dhe miratimi i Projektligjit “Për krijimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve” është parashikuar në: Planin Kombëtar për Integritimin Evropian 2024-2026 (Janar 2024) miratuar me VKM nr. 16, datë 11.01.2024 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integritimin Evropian 2024-2026”; në Programin e

Përgjithshëm Analitik të Projekt akteve për vitin 2024 të Ministrisë së Brendshme; në PKIE Kapitulli 24 “Liria, Drejtësia dhe Siguria”; në përmbushje të kërkesave të Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (Bruksel më 08.11.2023) ku citohet se ngritja e ZRA është një masë e nevojshme për përparim në luftën kundër krimit të organizuar në Shqipëri, si dhe në VKM nr. 736, datë 13.12.2023 “Për miratimin e udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji “Për krijimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve” synon të përmirësojë rezultatet e luftës kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe pastrimit të parave në Shqipëri. Në fushën e luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, janë bërë hapa të dukshëm para, që na çoi në heqjen nga Lista Gri. Por krijimi dhe funksionimi i ZRA lidhet me një serë përparësish që do ti japë zgjidhje disa problemeve të bashkëpunimit të pamjaftueshëm kombëtar dhe ndërkombëtar të Policisë së Shtetit në luftën kundër krimit të organizuar, në gjetjen dhe identifikimin e asetëve kriminale.

ZRA krijohet si strukturë e posaçme qendrore në Policinë e Shtetit, ku mund të shfrytëzojë me efektivitet data bazën e të dhënave të saj të konsiderueshme mbi subjektet e veprimtarisë kriminale dhe pasuritë e tyre, dhe gëzon pavarësi operacionale.

ZRA përfaqëson autoritetin kombëtar, në nivel qendror për realizimin e procesit të gjurmimit dhe identifikimit të asetëve kriminale që rrjedhin nga një vepër penale ose veprimtarisë kriminale të cilat mund ti nënshtrohen ngrirjes së përkohshme, sekuestrimit dhe konfiskimit nga autoritetet kompetente.

ZRA e shtrin aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Bazuar edhe në bazë të marrëveshjeve respektive ajo vepron edhe jashtë territorit të Shqipërisë.

ZRA në ushtrimin e veprimtarisë së saj udhëhiqet në parimet e profesionalizmit dhe integritetit, respektimi të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, urgjenca dhe efikasiteti, besimi reciprok, konfidencialiteti, pavarësia operacionale, paanshmëria politike, komunikimi i drejtpërdrejtë dhe elektronik, ruajtja e informacionit të klasifikuar.

ZRA në realizimin e përgjegjësisë dhe detyrave të saj kufizohet në gjurmimin dhe identifikimin e të ardhurave dhe pasurive kriminale, kërkesën dhe shkëmbimin e informacionit, shkëmbimin e praktikave më të mira, grumbullimin e statistikave, shkëmbimi i informacionit më ZRA e huaja, kërkesa dhe marrja e informacionit nga NJIF; shkëmbimi spontan i informacionit; bashkëpunimi me rrjetin CARIN; shkëmbimi i praktikave më të mira; mbrojtja dhe konfidencialiteti i të dhënave personale.

Drejtori i ZRA është autoriteti më i lartë ekzekutiv, administrativ dhe operacional i ZRA dhe përgjigjet para Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Ai përfaqëson ZRA si pikë qendrore e kontaktit të Shqipërisë me ZRA e huaja. Ai zgjidhet me mandat 5 vjeçar me të drejtë riemërimi një herë. Ai duhet të plotësojë një serë kriteresh që lidhen me zotësinë për të vepruar, arsimin, vjetërsinë, aftësinë profesionale, integritetin.

Krijimi dhe funksionimi i Komitetit Këshillimor, i cili këshillon dhe lehtëson veprimtarinë e ZRA, sugjeron praktikën më të mira që duhen ndjekur, jep mendime gjatë shqyrtimit të politikave, dokumenteve strategjike, akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me veprimtarinë e ZRA.

Me krijimin dhe funksionimin e ZRA rriten pritshmërinë për rezultate më të larta në luftën kundër krimit të organizuar dhe pasurive kriminale, pasi do të përmirësohet bashkëpunimi dhe bashkëveprimi ndërinstytucional i strukturave të zbatimit të ligjit në vendin tonë dhe i ZRA në Shqipëri me ZRA e huaja, në funksion të kërkimit, gjetjes, identifikimit, sekuestrimit, konfiskimit dhe rikuperimit të aseteve kriminale.

Shfrytëzimi i të dhënave të data bazave të Policisë së Shtetit, shkëmbimi spontan i informacionit, bashkëpunimi me rrjetin CARIN dhe rrjetet e tjera të rikuperimit të aseteve, komunikimi i drejtpërdrejtë elektronik, me urgjencë dhe efikasitet, pavarësia operationale janë disa risi që ligji i jep strukturës së ZRA.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji “Për krijimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve” është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin vendas.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji “Për krijimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve” është i përafuar me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji “Për krijimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve” është i përbërë nga 5 (pesë) kre dhe 28 (njëzet e tetë) nene.

Kreu i Parë (Dispozita të Përgjithshme) – përcakton objektin, juridiksionin, parimet bazë nga të cilat udhëhiqet ZRA në veprimtarinë e saj, krijimin e ZRA pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, drejtori i përgjithshëm i ZRA, përkufizimet mbi pasurinë, sekuestrimin, konfiskimin, shkëmbimin spontan të informacionit dhe informacionin inteligjent.

Kreu i Dytë (Përgjegjësitë funksionale dhe detyrat) – parashikon përgjegjësitë e ZRA të cilat mund të përmbliohen në gjurmimin dhe identifikimin e të ardhurave dhe pasurive, shkëmbimin e informacionit, shkëmbimin e praktikave më të mira, grumbullimin e statistikave, bashkëpunimin me Rrjetet Ndërinstitucionale të Rikuperimit të Aseteve; detyrat e ZRA që lidhen me gjetjen dhe identifikimin e të ardhurave dhe pasurive që burojnë nga një veprë penale ose veprimtari kriminale, shkëmbimi i informacionit më ZRA e huaja, kërkesa dhe marrja e informacionit nga NJIF; shkëmbimi spontan i informacionit; bashkëpunimi me rrjetin CARIN; shkëmbimi i praktikave më të mira; mbrojtja dhe konfidencialiteti i të dhënave personale.

Kreu i Tretë (Bashkëpunimi me organet dhe institucionet kombëtare) – parashikon Pikat e Kontaktit të institucioneve ligj zbatuese në vend me ZRA; kërkesat, njoftimet dhe dorëzimi i tyre pranë ZRA.

Kreu i Katërt (Bashkëpunimi me ZRA e Huaja) – parashikon kërkesat e ardhura nga jashtë, afatet dhe refuzimi i një kërkesë.

Kreu i Pestë (Baza e të dhënave elektronike) – parashikon krijimin e bazës së të dhënave dhe informacioni statistikor, nxjerrjen e akteve nënligjore dhe hyrjen në fuqi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit ngarkohen me zbatimin e ligjit “Për krijimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve”

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji “Për krijimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve” është hartuar nga Policia e Shtetit, me asistencën teknike të Këshillit të Evropës dhe Ministrisë së Brendshme “Veprimi kundër krimit ekonomik” si dhe me ekspertizën e Specialistëve të ZRA Franceze.

Projektligji “Për krijimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve” është dërguar për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë për Marrëdhënie me Parlamentin, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Këshillit të Lartë Gjyqësor, Agjencisë së Inteligjencës Financiare, Departamentit të Administratës Publike, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit.

Gjatë fazës së dhënies së mendimeve institucionet e sipërpërmendura janë shprehur, si vijon:

Ministria e Drejtësisë:

Janë reflektuar sugjerimet e Ministrisë së Drejtësisë me përjashtim të komentit të mëposhtëm:

- *Sipas ligji nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, është krijuar Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF), e cila ka të njëjtat kompetenca me Zyrën e Rikuperimit të Aseteve, që propozohet të krijohet. Duke qenë se nuk mund të ekzistojnë dy organe, të cilat kryejnë të njëjtat funksione dhe detyra por ndryshojnë vetëm nga varësia institucionale, do të duhet të rivlerësohen edhe njëherë kompetencat e kësaj zyre me qëllim që të mos kemi mbivendosje të kompetencave dhe paqartësi në zbatim të këtyre dy akteve në praktikë.*

Misioni, roli dhe kompetencat e ZRA nuk mbivendosen me ato të Agjencisë së Inteligjencës Financiare, referuar dhe acquis/praktikave të BE-se të cilat njohin njëkohësisht FIU dhe ARO. Për më tepër, projektligji për ZRA është përcjellë për mendim dhe pranë Agjencisë së Inteligjencës Financiare ku vlerësohet ngritja e ZRA në Shqipëri duke ofruar sugjerime të rëndësishme për funksionimin e saj. Së fundmi, ky projektligj vjen si rezultat i analizës së bërë dhe rekomandimeve të ofruara nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhër të Kryeministrit nr. 49, datë 23.05.2021 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e raportit për vlerësimin e kuadrit ligjor dhe rekomandimeve institucionale për ngritjen e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve”. Grupi i punës, i udhëhequr nga Ministria e Drejtësisë ka prodhuar dokumentin analitik përcjellë me Nr 1977 prot., datë 08.04.2022, duke theksuar si përfundim nevojën e “Ngritjes me ligj të një Zyre të tillë, e cila duhet të vendoset në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, dhe të shërbejë si pikë kontakti” (fq 30 e dokumentit analitik).

- *Parashikohet akses i palimituar në kontrollin që ZRA do të ushtrojë në regjistrin e centralizuar të llogarive bankare, pa e bazuar këtë kërkim në indicie, apo pa përcaktuar procedura kufizimi, ose mbikëqyrjeje gjatë këtij procesi për të shmangur shkelje të mbrojtjes së të dhënave personale. Sugjerojmë të shtohen mekanizma të tillë në projektligj.*

Ligji 154/2020, “Për regjistrin qendror të llogarive bankare” parashikon në nenin 4 si subjekt të interesuar dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ku ZRA është pjesë përbërëse e saj dhe i nënshtrohet rregullimeve përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit:

Janë reflektuar sugjerimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me përjashtim të komentit të mëposhtëm:

- *Vlerësojmë të shtohet një nen i ri me përmbajtje “Struktura organizative e ZRA” duke përfshirë përmbajtjen e pikës 2 dhe 3, të nenit 6.*

Neni i ri i propozuar nuk përbën vlerë të shtuar për sa kohë përfshihen nën emërtimin e “organizimit dhe funksionimit”.

Agjencia e Inteligjencës Financiare:

Janë reflektuar sugjerimet e Agjencisë së Inteligjencës Financiare me përjashtim të komentit të mëposhtëm:

- *Të riformulohet pasi në qoftë se ZRA ka akses, nuk ka kërkesë, pasi e merr drejtpërdrejtë informacionin. Nga ana tjetër nëse nënkupton të dhëna që nuk ka akses, afatet me orë nuk janë të aplikueshme për organet publike që nuk kanë shërbim me turne. Akoma më tej, informacioni që do dalë nga organet publike duhet të procedohet në formë zyrtare, pasi në të kundërt nëpunësi nuk është i autorizuar ta nxjerrë dhe përpunojë këtë informacion. Nëse informacioni gjendet në data baza të klasifikuara sekret shtetëror atëherë ka rregulla shtesë që duhen zbatuar;*

Duhet sqaruar që afatet e mësipërme i referohen shkëmbimit të informacionit mes ZRA-ve të vendeve të ndryshme dhe jo kërkesave të ardhura/drejtuar organeve të tjera. Afatet janë standard sipas *acquis* përkatëse

- *Afati të përcaktohet me ditë pune pasi jo të gjitha organet që do marrin kërkesa kanë punë me turne, sistemet nuk janë të hapura për kërkime 24 orë në ditë edhe për arsye sigurie etj.*

Afatet janë standard sipas *acquis* përkatëse, Direktiva e Bashkimit Evropian 2014/42/EU.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit ka sugjeruar që “*në projektligj duhet të parashikohet marrja e masave teknike dhe organizative të sigurisë për të garantuar standardet më të larta gjatë përpunimit të të dhënave personale nga autoritete kompetente. Gjithashtu, në këtë projektligj nuk gjejmë të parashikuar rregullime mbi nivelin dhe monitorimin e aksesit në databazat përkatëse. Monitorimi i aksesit dhe kërkimeve nga autoritetet kompetente është i rëndësishëm, pasi çdo institucion, në cilësinë e kontrolluesit në kuptim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, legjitimohet të aksesojë të dhëna personale, vetëm për atë që lidhet me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së tij. Është e nevojshme nga databaza e të dhënave të ndërtohet në mënyrë të tillë që të garantohet konfidencialiteti dhe akses i kufizuar në përputhje me qëllimin e përpunimit si dhe të sigurohet gjurmueshmëria për çdo ndërhyrje në databazat përkatëse”. Në vijim të këtij komenti për arsye qartësimi të jepet formulimi konkret i sugjeruar nga ana juaj.*

Në lidhje me sugjerimet e ardhura nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Departamenti i Administratës Publike, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, Prokuroria e

Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme janë reflektuar të gjitha komentet dhe sugjerimet e bëra.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Buxheti i ZRA është pjesë e programit buxhetor të emëruar “Policia e Shtetit”

PROPOZUESI

MINISTRI

Taulant Balla

Konceptoi: Xh. Fejza

Pranoi: A. Dekavelli A. Toma

Miratoi: M. Cuka

Konfirmoi: B. Beja B. Lamallari